



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr.298/2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Nehat Idrizi dhe Vlastimir Dimic, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Aleanca e Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së billboardave garues për zgjedhjet e përgjithshme para fillimit të fushatës zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 02.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë ankesa si e palejuar.

## A R S Y E T I M

Subjekti politik AKR me seli në Prishtinë, ka parashtruar një ankesë më të cilën pretendon se subjekti politik LDK me seli në Prishtinë, ka bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore nr.11/2009, Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, duke vendosur billboardet në Rrugën “Luan Haradinaj” dhe “Nëna Terezë” në Prishtinë, më përmbajtje garues për zgjedhjet e përgjithshme para se të filloj fushata zgjedhore.

## F A K T E T

Më 30.11.2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik AKR më të cilën pretendohet se subjekti politik LDK ka bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore nr.11/2009, Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, duke vendosur Billboardet, më përmbajtje garuese për zgjedhjet e përgjithshme para se të filloj fushata zgjedhore. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi që duken të jenë billboardet e fushatës së subjektit politik LDK. Parashtruesi i ankesës ka propozuar që PZAP-i të ndërmarrë masat e parapara ligjore për këtë çështje konform dispozitave të aplikueshme.

## ANALIZË

Juridiksioni i PZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP*, Ligji Nr.03/L – 256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L- 073 dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* Ligji Nr. 03/L- 072.

Me dispozitën e nenit 44 të LZP-së, përcaktohen aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe mënyrat e specifikuar me atë dispozitë. Në dispozitën e nenit 33 të LZP-së dhe Rregulloerja Zgjedhore nr.11/2009, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, me dispozitat e lartë cekura ju ndalohen veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatëve të tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Meqenëse veprimet e pretenduara nga parashtuesi i ankesës nuk janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, PZAP-i vlerëson se në pajtim me dispozitat e lartcekura ligjore nuk kemi të bëjmë me veprime të ndaluara. E në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

A nr. 298/2010 më datën 02.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

